

VENDIM
Nr.837, datë 6.12.2011

**PËR LEJIMIN E BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË KONTRATËS SË
NËNSHKRUAR, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE, SI AUTORITET
KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si autoritet kontraktor, të shpallë brenda datës 20 dhjetor 2011, në Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimin e fituesit dhe njoftimin e kontratës së nënshkruar, për tenderin, me objekt “Blerje *software*-i për sistemin e kalimit të të dhënave nga pajisjet fiskale”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha